

VENDIM
Nr. 22, datë 6.5.2026

**PËR DHËNIEN E LICENCËS DEGËS SË BANKËS SË HUAJ “DEGA E
BANKËS TURKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S., ALBANIA”
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 14, 20, 21, 23, pika 2, dhe 54 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; dhe të pikës 2, të shtojcës nr. 1, të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; si dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie e licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare degës së bankës së huaj “Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania” në Republikën e Shqipërisë.

2. Në zbatim të nenit 23, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dega e bankës së huaj “Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania” do të ushtrojë veprimtaritë bankare dhe financiare që ushtron banka e huaj “Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S.”, të cilat lejohen dhe parashikohen në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet Guvernatori me nënshkrimin e licencës dhe të aneksit të veprimtarive të degës së bankës së huaj “Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania”, pas paraqitjes në Bankën e Shqipërisë të konfirmimit të autoritetit licencues dhe/ose mbikëqyrës përgjegjës në Republikën e Turqisë për bankën e huaj “Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S.”, në lidhje me veprimtaritë bankare dhe financiare që ushtron kjo bankë.

4. Ngarkohet dega e bankës së huaj “Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania”, që të njoftojë me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për datën e fillimit të veprimtarisë.

5. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Operacioneve Monetare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

